



Nafta pa taksa për bujqësinë, MBZHR vë në dispozicion fondin 1.66 miliardë lekë

Faqe 5



24% toke bujqesore

Pse duhet të investoni në ferma blegtorale për prodhim qumështi

Faqe 7



Bimët mjekësore, burim të ardhurash dhe punësimi

Faqe 6



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit janar 2023

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 454
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

PREZANTOHEN 4 PRODUKTET SPECIALITET TRADICIONAL I GARANTUAR

MINISTRJA KRIFCA: CERTIFIKIMI I PRODUKTEVE CILËSORE TRADICIONALE, NË THEMELIN E PËRPPJEKJEVE TONA PËR TË FORCUAR QËNDRUESHMËRINË EKONOMIKE TË FERMAVE

Djathi Mishavina i Bjeshkëve të Kelmendit, Malësi e Madhe, Mjalti i Bedunicës, Përmet, Djathi i Ziem i Veleçikut, Malësi e Madhe dhe Djathi i Dhisë nga Bjeshkët e Rrunjës, Dibër, janë certifikuar për treguesit gjeografikë, emërtimin e origjinës dhe specialitetin tradicional të garantuar. Certifikimi u krye në praninë e Ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca dhe Ambasadorit të Republikës Federale të Gjermanisë Peter Zingraf. MBZHR ka identifikuar mbi 40 produkte tradicionale potencialisht që certifikohen nën këtë logo

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Zhvillimi i aftësive për punësim është thelbësor për një ekonomi më të fortë në Shqipëri

18 279 të rinj kanë zgjedhur arsimin e mesëm profesional



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



Ligji për Bletarinë, Krifca: Gur themeli për zhvillimin e sektorit



Faqe 6

TË RINJTË NË SIPËRMARRJE RURALE



Pasioni për kafshët, Klea: Veterinaria zgjedhja ime e parë

Faqe 5

KËNDI I EKSPERTIT

- Të ushqyerit plotësues të gicave në mëmëzim Fq.11
- "Roli i plehrave organike, norma dhe koha e plehërimit organik në drurët frutorë" Fq.11
- Ketoza në gjedhë Fq.12
- Këshilla/ rekomandime për fermerët, për masat që duhen marrë për mbrojtjen e kulturave bujqësore dhe specieve të kafshëve nga temperaturat e ulëta Fq.12
- Kalendari bujqësor, muaji shkurt 2023 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

FINANCIM

Programi IPARD III, grante për investimet në agropërpunim



Faqe 6

AZHBR

Selmanaj: Avantazhet e të rinjve në skemat mbështetëse në bujqësi

Faqe 5

RISI ALBANIA

Zhvillimi i aftësive për punësim është thelbësor për një ekonomi më të fortë në Shqipëri

18 279 të rinj kanë zgjedhur arsimin e mesëm profesional

Në Shqipëri, gjithnjë e më shumë, nxënësit po zgjedhin shkollat profesionale, për të gjetur veten shpejt në tregun e punës.

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj bëri të ditur se, rreth 18 279 të rinj kanë zgjedhur të studiojnë në arsimin e mesëm profesional në 23 drejtime mësimore.

Po ashtu, ajo informoi se janë 1574 mësimdhënës që japin kontributin e çmuar për Arsimin dhe Formimin Profesional në Shqipëri.

kuar në industrinë e tekstile, industrinë ushqimore, në vendosjen e skelave të ndërtimit, në mirëmbajtjen e makinerive industriale, në industrinë elektromekanike. Gjithashtu mungojnë saldatorë, elektrikistë, kuzhinierë, guida turistike, gjeologë, minororë, specialistë ashensorësh, etj.

Për të plotësuar këtë hendek, qeveria po i kushton vëmendje zhvillimit të shkollave profesionale. Në 35 shkolla profesionale në të gjithë Shqipërinë ofrohen 23 drejtime mësimore për t'u bërë profesionist.

sin dhe biznesin ka një rol kryesor, në proceset e vendimmarrjes për politikën e punësimit.

Ekspertët vlerësojnë se zhvillimi i aftësive për punësim është thelbësor për një ekonomi më të fortë në Shqipëri.

Pak kohë më parë Patrik Meier, Zv. Shef i Misionit, në Ambasadën e Zvicrës në Tiranë, bashkë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë u angazhuam në një seminar për t'u konsultuar mbi programet zvicerane në fushën e arsimit profesional.



“Arsimi Profesional, është një mjet i fuqishëm për t'i dhënë të rinjve një mundësi punësimi të sigurt për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm”, tha ajo.

Sipas Agjencisë Kombëtare të Punësimit, pjesa më e madhe e të rinjve punësohen duke ndjekur ende studimet.

Studimet e ndryshme kanë nxjerrë në pah se Shqipërisë i mungojnë punëtorë të kualifi-

Gjithashtu me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), MFE ka nënshkruar Programin Vendor të Punës së Denjë 2023-2026, i gjashti i këtij lloji.

Fokus i kësaj nisme është një projekt që do të angazhojë fonde të qeverisë shqiptare dhe të Bashkimit Europian për të garantuar vende pune dhe jetesë të denjë. Autoritetet vlerësojnë me shumë rëndësi dialogun social, ku bashkëpunimi me agrobizne-

Aktorë kyç (ministri, agjenci, shkolla profesionale, biznes dhe akademikë) diskutuan se si Zvicra mund të mbështesë më tej zhvillimin e aftësive.

“Shqipëria mund të krenohet me atë çka është arritur tashmë dhe Zvicra është gati të mbështesë reformat aktuale në arsimin profesional dhe punësimin”, tha Patrik Meier, Zv. Shef i Misionit, Ambasadë e Zvicrës.

Mundësi për të bërë biznes me 10 eksportues të mëdhenj shqiptarë të frutave dhe perimeve të freskëta

Eksportuesit më të mëdhenj shqiptarë të frutave dhe perimeve të freskëta, do të marrin pjesë në Panairin Ndërkombëtar “FRUIT LOGISTICA 2023”, i cili do të mbahet nga data 8-10 shkurt 2023, në Berlin të Gjermanisë.

FRUIT LOGISTICA 2023, është një nga aktivitetet më të rëndësishëm që u krijon mundësi sipërmarrjeve të huaja, për të bërë biznes me 10 nga eksportuesit më të mëdhenj shqiptarë të frutave dhe perimeve të freskëta.

Gateway & Partners ka nisur sezonin e Mbështetjes së Ekspozitave me Delegacionin Shqiptar të eksportuesve të frutave dhe perimeve të freskëta drejt FRUIT LOGISTICA 2023. Gama e produkteve natyrale që do të ekspozohen në këtë panair, është e gjerë dhe përfshin domate, tranguj, lakër, specë zile, hudhër, patate, agrume, manaferr,

ra, mollë, kumbulla, shalqinj, pjeshkë, qersh, shegë & goji berries etj.

Ky projekt mbështetet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, projekti i qeverisë zvicerane RisiAlbania dhe GIZ Albania.



Nëse jeni blerës i F&V dhe do të merrni pjesë në ekspozitë, mund të rezervoni një takim në Sallën 7.2B, Stand B-30 dhe do të keni mundësi-

inë të flisni dhe kontaktoni me 10 kompani shqiptare.

Dizenjimi i aktiviteteve të rëndësishme në sektorin e bujqësisë, që mbahen në Berlin, e kanë kthyer këtë qytet në pikën kryesore takimi të industrisë së frutave

të freskëta në botë, duke krijuar lehtësi dhe mundësi për shkëmbime tregtare dhe kontrata eksportesh me vlerë të shtuar.

BLEGTORI

Politika fiskale efikase për blegtorinë, diskutime me sipërmarrës të fermave

Hartimi sa më efikas i politikave fiskale për blegtorinë, me synim mbështetjen e

ipëria diskutuam mbi ndikimin e politikave fiskale në blegtori dhe zinxhirin prod-

mbështetje”.

“Diskutuam me ta gjithashtu dhe politikën mbështetëse për blegtorinë për këtë vit, të cilën, po e ndërtojmë në funksion të nevojave të sektorit por edhe duke dëgjuar ngushëtesisht grupet e fermerëve e blegtorëve”, theksoi ministrja.

Ndërkaq, në takim është folur edhe për ndërtimin e mekanizmave rregullatorë në lidhje me politikën fiskale dhe Skemën Kombëtare të Mbështetjes, për të siguruar bashkëpunimin e mirë mes palëve dhe zhvillimin me hapa të sigurt të Blegtorisë, me qëllim final produkt më të sigurtë dhe cilësor për konsumatorin



prodhimit vendas mbledhi në një tryezë diskutimi ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, ministren e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj me sipërmarrës të fermave blegtorale nga i gjithë vendi.

Në tryezë, diskutimi u përqendrua edhe tek propozimi për heqjen e taksës së hirrës dhe kremit të qumështit për të lehtësuar prodhuesit dhe tregtarët e këtyre produkteve.

Ministrja Krifca ndau në rrjetet sociale foto nga ky takim i rëndësishëm, teksa shkroi se “me ministren Delina Ibrahimaj dhe një përfaqësi të fermave blegtorale nga e gjithë Shq-



hues e përpunues duke siguruar blegtorët për transparencë të këtyre politikave dhe për

si dhe zgjerimin e eksporteve të sektorit në tregje të reja ndërkombëtare.

Mbështetje nga skemat kombëtare, blegtori nga Vajkani zgjeroi fermën

Altin Kaja nga Vajkani i Fierit është një nga blegtorët shembull, i cili ka arritur të zhvillojë një nga fermat e suksesshme të mbarështimit të lopëve.

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla solli sot përvojën e blegtorit, i cili është përfytyrë nga skemat mbështetëse të Qeverisë.

“Altini krahas këtij përkushtimi, lehtësive të ofruara falë investimeve të realizuara vit pas viti, kryesisht në infrastrukturë dhe skemat mbështetëse nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia për

Zhvillim Bujqësor dhe Rural, synon ta zgjerojë edhe më tej këtë aktivitet”, u shpreh Balla.

Balla theksoi se duhet të mbështetet blegtorët, pasi nuk ka më të mira se prodhimet vendase blegtorale.

“Unë jam një blegtor që merrem me mbarështimin e lopëve për qumësht dhe viçave për majmëri. Kam rreth 10 vjet që menaxhoj këtë biznes pasi e kam të trashëguar nga babai im”, u shpreh Altini.

“Fillimet kanë qenë paksa të vështira, sepse gjithmonë çdo biznes kur fillon është i

vështirë, por duke kaluar vitet dhe duke mësuar më shumë për blegtorinë kemi arritur në këtë pikë ku jemi sot”, tha ai.

Altini u shpreh se, aktualisht sot në fermë ka rreth 80 krerë lopë qumështi. “Për tregtimin e qumështit jemi shumë në rregull për arsye sepse kemi lidhur kontrata me kompaninë Lufra, kontratat janë shumë të rregullta, ato janë shumë korrekt ne jemi shumë korrekt dhe çmimi pothuajse ka arritur goxha mirë. Falë skemave themi që do ia dalim”, nënvizoi Altini.



PRODHIM AUTOKTON

PREZANTOHEN 4 PRODUKTET E CERTIFIKUARA SPECIALITET TRADICIONAL I GARANTUAR

MINISTRJA KRIFCA: CERTIFIKIMI I PRODUKTEVE CILËSORE TRADICIONALE, NË THEMELIN E PËRPPJEKJEVE TONA PËR TË FORCUAR QËNDRUESHMËRINË EKONOMIKE TË FERMAVE

Djathi Mishavina i Bjeshkëve të Kelmendit, Malësi e Madhe, Mjalti i Bedunicës, Përmet, Djathi i Ziem i Veleçikut, Malësi e Madhe dhe Djathi i Dhisë nga Bjeshkët e Rrunjës, Dibër, janë certifikuar për treguesit gjeografikë, emërtimin e origjinës dhe specialitetin tradicional të garantuar. Certifikimi u krye në praninë e Ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca dhe Ambasadorit të Republikës Federale të Gjermanisë Peter Zingraf. MBZHR ka identifikuar mbi 40 produkte tradicionale potencialisht që certifikohen nën këtë logo

Katër produktet e para të regjistruara si marka të mbrojtura kanë kaluar procesin e verifikimit të përputhshmërisë me karakteristikat e produktit, duke mundësuar kështu vendosjen e logos kombëtare dhe prezantimin e tyre në treg.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, gjatë prezantimit të këtyre produkteve, dha garaci për vijimin e punës në certifikimin edhe të produkteve të tjera, që janë një vlerë e shtuar për ekonominë rurale. “Do të vijojmë punën për të mbështetur dhe certifikuar

cionin e qartë lidhur me karakteristikat specifike të produktit, origjinën, metodën e prodhimit, duke mundësuar kështu që konsumatorët të bëjnë zgjedhje më të informuara, ruajmë larminë e prodhimit bujqësor dhe blegtoral të zonës bashkë me traditën, si dhe garantojmë cilësinë e produktit sipas specifikimeve të tij, si edhe kontribuojmë në rritjen e të ardhurave për prodhuesit, përmes çmimit më të lartë krahasuar me produkte të ngjashme në të njëjtën kategori ushqimore”, tha Krifca.

Ministrja solli në vëmendje se vitet e fundit në Shqipëri,

ditës dhe historisë së produktit. Këto produkte përfaqësojnë një pjesë të traditës sonë ushqimore por edhe identitetin tonë. Gjithashtu, ato kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, promovojnë fshatin dhe zonat më të thella rurale, mundësojnë punësim më të lartë direkt dhe indirekt, kontribuojnë në zhvillimin më të barabartë rajonal dhe rural, parandalojnë migrimet e popullsisë, si dhe mundësojnë mbrojtjen e njohurive dhe dijetërisë tradicionale”, theksoi Krifca.

“Produkte të tjera të regjistruara si produkte të mbrojtura me Tregues Gjeografik që ne do të punojmë për t’i certifikuar janë edhe Gështenja

këve të Kelmendit”, Emërtim Origjine e Mbrojtur, është përdorur me këtë emër për më shumë se 100 vjet, por mendohet që ka një histori edhe më të hershme.

Është një produkt që përdoret për të respektuar mikun dhe për t’u ndjerë krenarë, i lidhur me traditën blegtorale të zonës dhe pozitën gjeografike, me temperatura të përshtatshme për ruajtje. Kullotat e Kelmendit janë të tipit alpin e subalpin me lartësi 1500 – 2400 m, mbi nivelin e detit, me specie kryesore gramore.

- Mjalti i Bedunicës, Përmet, Specialitet Tradicional i Garantuar. Është lulja e Bedunicës, aq e rrallë, që

sisë së Madhe: Kastrat, Shkrel dhe Kelmendi i Poshtëm. Në llojin e tij më tradicional, produkti duhet të jetë marrë nga qumësht lope i sapomjelë, që vjen i papërpunuar në punishte. Produkti ka qenë rezervuar për mysafirë specialë dhe vetëm gratë e shtëpisë dinin ta përgatisnin dhe e trashëguan tek më të rejtat. Anëtarët e grupit të prodhuesve dhe banorë të tjerë të zonës, dëshmojnë se në familjet e tyre djathi i ziem është përgatitur për më shumë se një shekull dhe gatuhej vetëm kur në shtëpi vinin mysafirë të rëndësishëm.

- Djathi i dhisë, bjeshkët e Rrunjës, Dibër (Specialitet Tradicional i Garantuar),

“Valm”, vaj i prodhuar me ullinj të autoktonë të zonës së Elbasanit. Një model i krijimit dhe funksionimit të bashkimit të prodhuesve; Vaji i Ullirit të zonës së Tiranës, me ullinj të autoktonë të zonës, një tjetër model suksesi i bashkimit dhe promovimit të produkteve të zonës, nga vëllezërit Allgjata, Vaj ulliri “Kalinjot”, ullinj të autoktonë të Vlorës, Molla e Dvoranit, si një produkt me emërtim origjine të mbrojtur, në bashkëpunim me shoqatën “ADAD Malore”, Kumbulla e thatë e Dibërës, Glikotë e Përmetit, Domatja e Shëngjergjit, Gjeli i Detit i Baldushkut, etj”, tha Krifca.

Ministrja vuri në dukje se



edhe 40 produkte të tjera që janë identifikuar me potencial për t’u regjistruar së shpejti” tha ministrja.

Analizat ekonomike në Shqipëri tregojnë se konsumatorët janë të gatshëm që të paguajnë 30-50% më shumë për produktet që vijnë nga një zonë e identifikuar për cilësinë e veçantë të prodhimeve. Për produkte specifike si mjalti p.sh., kjo diferencë në çmim është edhe më e lartë.

“Me anë të këtyre skemave të cilësisë ne garantojmë mbrojtjen e të drejtave të grupeve të prodhuesve, informa-

produktet tradicionale kanë filluar të njihen gjithnjë e më shumë nga konsumatorët. “Për më tepër, zhvillimi i agroturizmit si një trend i qëndrueshëm ka ndikuar në zhvillimin dhe promovimin e produkteve tradicionale, duke krijuar një lidhje natyrore midis agroturizmit, fermave turistike dhe prodhuesve vendas”.

“Ato janë edhe në themel të krijimit të një aparati ekonomik të diversifikuar, i cili prodhon vlerë përmes cilësisë dhe dijes duke i ofruar konsumatorit jo vetëm produktin por edhe një copëz të natyrës, atij territori, paisazhit, klimës, tokës, tra-



dhe Mjalti i Gështenjës së Tropojës, Mjalti i Gështenjës së Reçit, Boronica e Bjeshkëve të Tropojës dhe e Bjeshkëve Kuksiane, Jufka Dibrane, Mishi i Dhisë së Hasit, etj. Ndërkohe sot ne certifikojmë 4 produktet e para, të cilat janë regjistruar dhe kanë kaluar procesin e verifikimit të përputhshmërisë me karakteristikat e produktit duke mundësuar kështu vendosjen e logos kombëtare dhe prezantimin e tyre në treg” tha Krifca.

- Djathi “Mishavina e Bjesh-

ndodhet me shumicë në zonën e Frashërit dhe parkut kombëtar të Bredhit të Hotovës, ajo që e bën këtë mjaltë kaq të veçantë me aromën, shijen dhe veçoritë e tij të rralla. Lulja e Bedunicës, është e vetmja lule që rritet në malin e Teprit, Gostivisht, Përmet në rreth 1500 m mbi nivelin e detit.

- Djathi i ziem, Hot, Malësi e Madhe (Specialitet Tradicional i Garantuar). Prodhet nga qumështi i lopës i grumbulluar në zonën përreth Malë-

prodhet nga qumështi i freskët i dhive të Bulacit, të grumbulluar nga barinjët që i mbajnë dhite në bjeshkët e Runjës, gjë që i jep një aromë të veçantë të qumështit të bjeshkëve, si rezultat i sistemit kullësor dhe mënyrës tradicionale të përpunimit. “Por ky zhvillim, vijoi ministrja, nuk mbaron këtu. Tashmë po punojmë edhe me produktet e tjera krenari të historisë sonë të prodhimit bujqësor, përfaqësuesit e të cilëve i kemi këtu, si Vaji

është bërë një punë e madhe dhe falenderoi GIZ-in për punën hulumtuese, ndërsa shprehu vlerësim për anëtarët e komisionit të ngritur pranë Ministrisë që kanë punuar me shumë përkushtim duke bërë të mundur këtë proces.

Në aktivitetin e organizuar me këtë rast në ambjentet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ishte i pranishëm edhe Ambasadori i Gjermanisë në vendin tone, Peter Zingraf, si dhe prodhues të sektorit.

Kryeministri Rama: Certifikimi i produkteve, vlerë e shtuar e markës “Made in Albania”

Prodhuesit e ekselencës tradicionale tashmë i kanë produktet të mbrojtura e të certifikuar, si vlerë e shtuar e markës “Made in Albania”.

Kryeministri Edi Rama ndau në rrjetet sociale dëshmitë e ekspertëve të ushqimit dhe vetë prodhuesve mbi përfitimet që sjell certifikimi i produkteve.

Vitet e fundit në Shqipëri, produktet tradicionale kanë marrë një vlerë të veçantë. Zhvillimi i agroturizmit ka ndikuar në zhvillimin dhe promovimin e produkteve

tradicionale përmes një lidhje natyrore mes agroturizmit, fermave turistike dhe prodhuesve vendas.

Puna për identifikimin, regjistrimin dhe mbrojtjen e produkteve bujqësore dhe ushqimore ka filluar vite më parë, por miratimi i ligjit dhe akteve nënligjore për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore



dhe ushqimore i hapën rrugë njohjes dhe certifikimit të tyre me tre sisteme kryesore të përfuara me BE-në si treguesi gjeografik, emërtimi i origjinës dhe specialiteti tradicional i garantuar.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca u shpreh se certifikimi është garanci për aksesin në treg të

prodhuesve të vegjël.

“Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka zhvilluar rrugën e qartë ku duhet të ecin këta prodhues të vegjël për të rritur vlerën e produkteve të tyre”, tha ajo.

Sipas ekspertit të ushqimit, Armand Kikino “pas një pune disavjeçare janë certifikuar produktet e para tradicionale,

certifikim që konfirmon dhe plotëson identitetin e produktit, i jep garanci konsumatorit mbi origjinën dhe cilësinë e tij si dhe i siguron prodhuesit një treg të mirë dhe çmim të drejtë.

“Komisioni i Skemave të Cilësisë fton të gjitha bashkësitë e prodhuesve të bëhen pjesë e këtyre skemave”, tha ai.

Deri më sot është bërë identifikimi i mbi 40 produkteve që kanë potencialin për t’u certifikuar shumë shpejt.

AKTUALITET

Vlerësimi nga “Decanter”, Rama: Potencial i jashtëzakonshëm për verëra cilësore

Vera shqiptare ka marrë vëmendjen e revistës prestigjioze britanike “Decanter”.

Kryeministri Edi Rama

Shqipëria vlerësohet si potencial i jashtëzakonshëm për prodhimin e verërave cilësore.

“Për herë të parë vera shq-

“Decanter”, e cila vlerëson me fjalë tejet inkurajuese disa nga kantinat dhe etiketat më të mira të vendit, si edhe Shqipërinë si potencial i jashtëzakonshëm për prodhimin e verërave cilësore, duke konfirmuar një sukses të politikës sonë mbështetëse për këtë prodhim identitar të kulturës bujqësore të një vendi”, u shpreh Rama në rrjetet sociale.

Revista prestigjioze vlerëson historia vreshtare e Shqipërisë daton të paktën në shekullin e 8-të para Krishtit, kur ilirët e lashtë banonin në gadishullin Ballkanik; megjithatë, tani, gati 3,000 vjet më vonë, Shqipëria është në fazën fillestare të zhvillimit të verës moderne, një diamant pothuajse i panjohur për shumicën e botës së verës.



ndau shkrimin e kësaj reviste, teksa theksoi se në shkrim

iptare merr vëmendjen e revistës prestigjioze britanike

Artikulli i “Decanter” për verërat shqiptare, Krifca: Industri me potencial për ekonominë rurale

Revista prestigjioze botërore “Decanter” i ka kushtuar një

Darrel Joseph ka dhënë një pasqyrë kuptimplotë të zhvil-

vetë gjatë vizitës në territor në nëntor, e të cilën e ka pasqyruar në faqet e prestigjiozës botërore “Decanter”.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca ndau shkrimin e “Decanter”, ndërsa theksoi se “pas miratimit të ligjit të ri të vreshtarisë dhe verës, po punojmë për përfundimin e kadastrës së vreshtave, ndërkohë që fuqizojmë përditë e më shumë bashkëpunimin dhe mbështetjen me vreshtarët dhe prodhuesit e verës”.

Krifca tha se vëmendja e “Decanter” është një tjetër sukses ndërkombëtar për këtë industri me potencial të jashtëzakonshëm për ekonominë rurale në vendin tonë.



artikull verërave shqiptare. Gazetari i mirënjohur

limit të vreshtarisë dhe verëtarisë në vend, çka ai konstatoi

Djathi Mishavina i Bjeshkëve të Kelmendit, Malësi e Madhe, Mjalti i Bedunicës, Përmet, Djathi i Ziem i Veleçikut, Malësi e Madhe dhe Djathi i Dhisë nga Bjeshkët e Rrunjës, Dibër, janë produktet e para që certifikohen për treguesit gjeografikë, emërtimin e origjinës dhe specialitetin tradicional të garantuar.

Kelmendit janë të tipit alpin e subalpin me lartësi 1500 – 2400 m, mbi nivelin e detit, me specie kryesore gramore.

Djathi Mishavinë, prodho-

Certifikimi i produkteve të origjinës, prodhuesit ekselentë ruajnë traditën

Bedunicës, është e vetmja lule (në periudhën gusht dhe shtator), që rritet në malin e Teprit, Gostivisht, Përmet në rreth 1500m mbi nivelin e detit.

Shumë pak familje në zonën e Frashërit, dhe fshatit Gostivisht në Parkun Kombëtar të Hotovës prodhojnë këtë mjaltë, pasi shumica e luleve të Bedunicës gjenden në zona malore që janë të vështira për t'u arritur. Bletët jetojnë në një zonë me bimësi krejtësisht të egër dhe larg pemëve frutore, larg fshatit. SHBB “Mjalti i Bedunicës, Gostivisht”, aktualisht me 7 anëtarë, prodhon këtë lloj mjalti.

Në këtë rajon, kosheret e bletëve vendosen pranë shkurreve dhe luleve të bedunicës për të lehtësuar vjeljen. Bletët e mbledhin nektarin në një zonë të egër, larg pemëve frutore të kultivuara, larg zonavave të banuara. Bletët mbahen në koshere konvencionale prej druri drejtkëndëshe. Mjalti mbledhet me dorë gjatë tetorit dhe nxirret duke përdorur një centrifugë manuale. Tymosja e koshereve bëhet duke prodhuar tymin nga materiale bimore me strukturë celuloze, në mënyrë

het me qumësht të pavluar (të papasterizuar), nga bagëtitë (lopë dhe dele), që kullosojnë gjatë verës në kullota alpine. Karakteristikat specifike të djathit, janë struktura, copëzat e imta, aroma karakteristike, shija delikate, si dhe niveli i lartë i tretshmërisë.

Mjalti i Bedunicës, Përmet (STG)

Është lulja e Bedunicës, aq e rrallë, që ndodhet me shumicë



Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca u shpreh optimiste dhe krenare për këtë arritje ekselente të prodhuesve të bujqësisë.

“Krenarë për prodhuesit tanë ekselentë që ruajnë traditën dhe të gjithë punën e bërë në bashkëpunim me prodhuesit, pushtetin lokal, shoqatat dhe ekspertë të ushqimit, për bashkëpunimin në ngritjen e strukturës për identifikimin, regjistrimin, mbrojtjen e origjinës përmes certifikimit”, tha Krifca.

Djathi “Mishavina e Bjeshkëve të Kelmendit”, Vermosh, Kelmend (EOM)

Djathi Mishavinë, është përdorur me këtë emër për më shumë se 100 vjet, por mendohet që ka një histori edhe më të hershme.

Është një produkt që përdoret për të respektuar mikun dhe për t'u ndjerë krenarë, i lidhur me traditën blegtorale të zonës dhe pozitën gjeografike, me temperatura të përshtatshme për ruajtje. Kullotat e



në zonën e Frashërit dhe parkun kombëtar të Bredhit të Hotovës, ajo që e bën këtë mjaltë kaq të vecantë me aromën, shijen dhe vecoritë e tij të rralla. Lulja e

që mos t'i kalojnë mjaltit aroma të pakëndëshme.

Mjalti ka ngjyrë të verdhë në të gjelbërt, me një aromë të fortë dhe konsistencë të trashë

që lidhet me përqindjen e ulët të lagështisë, rreth 16%.

Djathi i ziem, Hot, Malësi e Madhe (STG)

“Djathi i ziem” është një traditë e vjetër e Shqipërisë së Veriut, dhe që vazhdon të prodhohet edhe sot në sasi të kufizuara. Sot, ky gatim unik i veriut të Shqipërisë është ndër specialitetet kryesore të restoranteve me gatime tradicionale shqiptare. Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) “Djathi i Ziem Veleçik”, aktualisht me 10 anëtarë, vazhdon të prodhojë këtë specialitet duke respektuar mënyrën tradicionale të përgatitjes së tij.

Termi “i Ziem” është i lidhur me karakterin specifik të përgatitjes së tij, një gatim i veçantë që është trashëguar gojarisht brez pas brezi.

Prodhet nga qumështi i lopës i grumbulluar në zonën përreth Malësisë së Madhe: Kastrat, Shkrel dhe Kelmend i Poshtëm. Çdo fazë e procesit të prodhimit respekton mënyrën tradicionale të prodhimit, pavarësisht modernizimit të pajisjeve. Në llojin e tij më tradicional, produkti duhet të jetë marrë nga qumësht lope i sapomjelë, që vjen i papërpunuar në punishte. Karakteristikat specifike të djathit janë struktura e tij e butë dhe elastike, si edhe shija delikate e pak e athët.

Kjo recetë ka qenë rezervuar për mysafirë specialë dhe vetëm gratë e shtëpisë dinin ta përgatisnin dhe e trashëguan tek më të rejtat. Anëtarët e grupit të prodhuesve dhe banorë të tjerë të zonës, dëshmojnë se në familjet e tyre djathi i ziem është përgatitur për më shumë se një shekull dhe gatuhej vetëm kur në shtëpi

vinin mysafirë të rëndësishëm. Është një gatim mjaft kalorik, i përshtatshëm për zonat e ftohta, karakteristike e veriut të Shqipërisë, me temperatura relativisht të ulëta.

Mënyra e prodhimit dhe përgatitjes ndryshon nga të gjithë djathërat e tjerë të freskët. Produkti ndryshon nga djathërat e tjerë nga struktura e tij elastike dhe shija pak e athët. Ai nuk shërbehet i freskët, por i gatuar. Serviret i ngrohtë, pa lejuar që të ngrijë.

Djathi i dhisë, bjeshkët e Rrunjës, Dibër (STG)

Djathi i dhisë bjeshkët e Rrunjës, prodhohet nga SHBB «Dhija autoktone e Bulacit», në Muhur, Dibër, e përbërë nga 7 anëtarë. Ai prodhohet



nga qumështi i freskët i dhive të Bulacit, të grumbulluar nga barinjët që i mbajnë dhite në bjeshkët e Rrunjës, gjë që i jep një aromë të veçantë të qumështit të bjeshkëve, si rezultat i sistemit kulloror dushk, shkozë, kullotat alpine dhe mënyrës tradicionale të përpunimit.

Historia e prodhimit të djathit fillon 60-70 vjet më parë nga gjyshja e familjes Voka, që e grumbullonte dhe përpunonte qumështin direkt në bjeshkët e

Runjës.

Prodhimin e djathit fillon nga muaji maj deri në mes të tetorit, duke përpunuar qumështin e grumbulluar (dallohët për rrezen e lartë rreth 15 kg/kv). Djathi ka ngjyrë të bardhë, të njëtrajtshme dhe aromën e këndshme karakteristike të qumështit të dhisë nga bjeshkët.

Emri “Djathi i dhisë, bjeshkët e Rrunjës”, i rezervohet djathit që prodhohet ekskluzivisht nga qumështi i dhisë së Bulacit, që bën pjesë në racat autoktone, regjistruar në Katalogun e Burimeve Gjenetike Shtazore të Fermës në Shqipëri, të vitit 2008.

Ekotipet vendase të dhisë janë krijuar ndër shekuj falë pasionit e punës së blegtorëve. Njihet, që në periudhën e Skënderbeut ka pasur rreth 3 000 krerë dhi, që janë trashëguar përmes përzgjedhjes së vazhdueshme të gjeneratave dhe sot kemi ekotipe vendase që përbëjnë një pasuri të shkëlqyer gjenetike – tradicionale.

Zona njihet për traditën qindravjeçare të mbajtjes së dhive në këtë territor (bjeshkët e Rrunjës 400 – 1 700 m lartësi), si dhe në shfrytëzimin e sistemit kulloror dushk, shkozë, kullotat alpine. Të gjitha fermat e përfshira në këtë territor kanë të përbashkët pikërisht shfrytëzimin e këtij sistemit kulloror. Dhite i rezistojnë temperaturave të ulëta të zonës dhe dalin të kullosojnë edhe kur është shumë ftohtë.

TË RINJTË NË SIPËRMARRJE RURALE

Pasioni për kafshët, Klea: Veterinaria zgjedhja ime e parë

Klea ka vetëm dy muaj që i është bashkuar trupës veter-

punësuar si veterinere shërbi- mi në zonën e Labinot Fushës,

të ndjekë studimet për mjekësi veterinare.

“I dua shumë kafshët. Veterinaria ka qenë zgjedhja ime e parë, kur vendosa që të ndjek studimet e larta. Jam shumë e lumtur që një nga ëndrrat e mia më të mëdha u bë realitet. Finalizimi i kësaj ëndrre ishte kur nisa ushtrimin e profesionit”, shprehet Klea.

Sipas saj, të kujdesesh për shëndetin e kafshëve është një detyrë e vështirë, pasi një mjek i përgjegjshëm duhet ta gjejë diagnozën në sajë të shenjave klinike.

“Për të kurrë nuk është e lehtë, pasi ata komunikojnë me mjekun. Me kafshët është ndryshe. Ne duhet të nisemi nga shenjat klinike për ekzaminimet”, tregon e sapo diplomuara për veterinari.



inare të Agjencisë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

duke pasur në përgjegjësi ferma me shpendë, ferma blegto- rale dhe parqe me bletë.

Pasioni për kafshët e bëri që

Me mbështetjen e AZHBR-së, pika e grumbullimit në Shkozet zgjeroi kapacitetin

Krenar Aliko, në Shkozet të Durrësit merret me tregtimin e produkteve të ngrira agrobuj- qësore, kryesisht bizele, akul- lore, produkte mishi dhe të tjera.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, ndau në rrjete sociale historinë e kësaj sipërmarrjeje, teksa vuri në dukje se me mbështetjen e programit IPARD, Krenari zgjeroi kapacitetet frigoriferike të ruajtjes dhe tregimit të produkteve të ngrira, sipas standardeve më të mira.

“Aktivitetin e kam filluar në vitin 2007, fillimisht me pa- taten “frite” nga jashtë, pastaj akulloren, mishin dhe produk- tet e tjera të ngrira”, tregon Aliko.

Ai thotë se përmes fondeve të IPARD-it, arriti të bënte re- alitet pasionin e tij për ta zhvil- luar më tej biznesin.

“Kur pashë fondet e IP- ARD, e kisha një ide për të

zgjerruar kapacitetin tim dhe ta zëvendësoja produktin e impor-

Këtë vit, tregon ai, kam shtu- ar edhe frutat e ngrira që i marr



tit me prodhimin vendas duke pasur një avantazh konkurrimi në treg me prodhimet e vendit. Me mbështetjen financiare të IPARD në 2021 kam shtuar dhomat frigoriferike, duke e shtuar kapacitetin magazinues nga 100 tonë në 300 tonë prodhime të ngrira”, tha Aliko.

nga disa zona të Shqipërisë. “Kërpudhat i marr nga Tropoja, qershitë i marr në Fier si dhe një pjesë të perimeve si bizeleve, mashurka, karota. Ideja dhe vizioni që unë kisha konceptuar nuk do të merrte kurrë formë pa mbështetjen e madhe të AZHBR-së”, tha Aliko.

Me mbështetjen e AZHBR-së, Driloni ndërtoi pikën e grumbullimit dhe përpunimit të bimëve mjekësore

Drilon Voci prej disa vitesh ushtron aktivitetin e tij për mbledhjen e bimëve mjekësore – aromatike dhe përpunimin e tyre në Vajkal të Bulqizës.

I mbështetur nga AZHBR përmes programit IPARD II, ai ndërtoi magazinën e grumbullimit dhe linjën e plotë të përpunimit të BMA-ve.

Driloni ka disa të punësuar dhe magazina e grumbullimit e krijuar përmes IPARD II, krijoj mjaft lehtësi edhe për fermerët e tjerë të zonës.

Së fundmi, ai po kërkon të realizojë kultivimin e BMA – ve dhe së bashku

me me QTTB Shkodër po eksperimentojnë kultivimin e trumzës në tokat djerrë. (Vajkal, Bulqizë).

Në këtë mënyrë, ata synojnë shfrytëzimin e këtyre tokave

dhe rritjen e prodhimit.

Në pritje të rezultateve pozitive kjo strategji do të aplikohet edhe për bimë të tjera medicinale që mund të rriten në kushte të ngjashme.



Selmanaj: Avantazhet e të rinjve në skemat mbështetëse në bujqësi

Agjencia për Zhvillimin Buj- qësor dhe Rural (AZHBR) po vijon bashkëpunimin me disa universitete të vendit, që kanë në kurrikulat e tyre degën e bu- jqësisë, me qëllim informimin e të rinjve për programet e mbështetjes në bujqësi.

Drejtoresha e AZHBR-së, Eranda Selmanaj, gjatë një takimi që zhvilloi sot në Tiranë, me akademikë e profesorë të universiteteve, vuri në dukje se, të rinjtë në bujqësi janë e ardhmja e sektorit.

Sipas saj, AZHBR vi- jon bashkëpunimin me uni- versitetet dhe institucionet në kuadër të zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit në fushën e agrobi- znesit dhe ekonomisë rurale.

“Objekti kryesor është

një përgatitje më cilësore e studentëve, informimi dhe

theksoi Selmanaj. Selmanaj shtoi se AZHBR



ndërgjegjësimi i tyre mbi vlerat dhe të ardhmen e sektorit bujqë- sor, gjithashtu mbi avantazhet e të rinjve në skemat mbështetëse”,

ka mbështetur dhe do të vazh- dojë të jetë pranë të rinjve duke nxitur sipërmarrjet në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Nafta pa taksa për bujqësinë, MBZHR vë në dispozicion fondin 1.66 miliardë lekë

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka vendosur

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është në vi-

Fermerët që nuk janë të pajisur me NIPT fermeri duhet të pajisen me të duke ndjekur procedurën në Agjencitë Ra- jonale të Ekstensionit Bujqë- sor (AREB).

Në 2021 u zbatua për herë të parë skema e mbështetjes me naftë falas për fermerët që vijoi zbatimin edhe në 2022, duke përfshirë për herë të parë rimbursimin e akcizës dhe taksës të qarkul- limit për fermerët që kul- tivojnë dru frutorë, arrorë dhe perime.

Shteti subvencionon 80,4 lekë nga çmimi i naftës që përfshin akcizën, taksën e qarkullimit, karbonit dhe TVSH-në. Për 2022 përfituan 34,731 fermerë naftë pa taksa me vlerë fond financimi 1,95 miliardë lekë.



në dispozicion mbi 1.66 mil- iardë lekë, si fond limit për blerjen e 6.3 milionë litrave karburant, që shkojnë tek fermerët.

tin e tretë të zbatimit të skemës mbështetëse naftë pa taksa për bujqësinë, duke i ardhur në ndihmë fermerëve për uljen e kostove të prodhimit.

Kontrollet e tregut agro-ushqimor, Shqipëria pjesëmarrëse në trajnimin në Athinë

Në Athinë u zhvillua tra- jnimi mbi kontrollet e tregut

përmirësimin e njohurive, si dhe qasjen në praktikat

Tradicional i Garantuar, Emërtim Origjine apo për Tregues Gjeografik.

Në cilësinë e produk- tit përfshihen treguesit gjeografikë, të cilët thek- sojnë marrëdhënien midis rajonit gjeografik dhe emrit të produktit, ku një e dhënë specifike ose karakteristike t'i atribuohet në thelb rajonit të tij gjeografik.

Ky sistem u krijua nga Bashkimi European për të informuar konsumatorët për veçoritë specifike të produkteve, si dhe për të mbrojtur tiparet karakteris- tike të emërtimeve të tyre gjeografike (si ne rastin e verërave) dhe gjithashtu disa skema cilësore për produktet ushqimore dhe bujqësore, specialiteti tradicional i ga- rantuar (STG).



agro ushqimor, verërave dhe pijeve alkoolike, ku Shqipëria mori pjesë me përfaqësues in- spektorët e Autoritetit Kom- bëtar të Ushqimit.

Trajnimi kishte si synim

e shteteve anëtare të Bash- kimit European për rritjen e efikasitetit të autoriteteve kompetente dhe organeve të kontrollit për Certifikimin e produkteve si Specialitet

Ligji për Bletarinë, Ministria: Gur themeli për zhvillimin e sektorit

Ligji i ri për Bletarinë vjen si një mbështetje e fortë për zhvillimin e këtij sektori dhe ndihmon bletarët të rrisin konkurrueshmërinë e tyre pasi ka ende potenciale të pasfrytëzuara në bletari dhe

pune të madhe dhe angazhimi gjithëpërfshirës me shoqatat e bletërritësve dhe ekspertëve më në zë të fushës. Ligji është në përgjigje të kërkesës së kahershme të komunitetit të bletarëve, por

themel të punës tonë, duke njohur mirë atë se çfarë vjen nga ferma në tryezë”, tha ministria.

Krifca tha se “ligji i ri krijon stimuj për vendosjen dhe qëndrimin e të rinjve në sektorin e bletarisë dhe siguron mbështetje për bletarët, sidomos për ata që operojnë në zonat e thella. Me këtë projektligj i japim fund monitorimit të specieve, shtegtimin të tyre të pakontrolluar dhe trajtimin pa kriter të sëmundjeve të tyre me pasojë dhe në humbjen e kolonive të bletëve”.

Sipas saj, “bletaria është një sektor që ka shënuar rritje të qëndrueshme dhe vetëm gjatë këtij viti kemi një prodhim prej gati 5 200 tonë mjaltë”.

Krifca shprehu mbështetjen e vazhdueshme dhe të qëndrueshme të qeverisë për bujqësinë, fermerët dhe nxitjen e të rinjve në sipërmarrjet rurale.

Në fund të vitit të kaluar u alokua një buxhet shtesë me një fond 160 milionë lekë duke plotësuar të gjithë kërkesën për mbështetje për bletërritësit. Ndërkohë, 3 mijë bletarë u mbështetën me një total financimi prej 310 milionë lekësh, vetëm për vitin 2022.



eksporte.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca publikoi në rrjete sociale një video informuese mbi rëndësinë e këtij ligji që u shqyrtua dhe miratua së fundi në Komisionin e përhershëm të Kuvendit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Krifca tha se, “ky ligj i rëndësishëm, vjen pas një

edhe si kërkesë e kohës dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të bletarisë”.

“Me këtë ligj të ri, ne përcaktojmë rregulla për regjistrimin, transportin, etiketimin, kontrollin dhe eksportin. E mbrojmë racën e bletës tipike autoktone duke mbrojtur mjedisin dhe prodhimin agropjor, garantojmë sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit, si

Bimët mjekësore, burim të ardhurash dhe punësimi

Bimët aromatike medicinale në Shqipëri, përbëjnë një ndër fokuset kryesore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke synuar forcimin e mëtejshëm të këtij sektori.

Krahas mbështetjes së drejtpërdrejtë që adreson MBZHR përmes Skëmës Kombëtare dhe Programit IPARD, në bashkëpunim me donatorët

vues të BAM, duke i dhënë prioritet pjesëmarrjes së të kthyerve nga emigrimi, të rinjve dhe grave.

Gjithashtu, trajnime të tjera në Shkodër kanë përfshirë edhe eksportues e përfaqësues të institucioneve shtetërore, të cilat ndikojnë në zinxhirin të prodhimit si Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) në Shkodër dhe

SHBA është me origjinë nga Shqipëria.

Bimët mjekësore dhe aromatike (BMA-të) janë një sektor tradicionalisht i orientuar nga eksporti, me tregje të zhvilluara dhe potencial të mirë për rritje.

Shqipëria bën pjesë në grupin e 25 eksportuesve kryesorë të BMA-ve në botë. Eksporti i BMA-ve arrin gati 20% të totalit të eksporteve bujqësore të Shqipërisë.

Produktet më të rëndësishme të eksportit janë sherbeli, rigoni, trumza, livando, etj. Është regjistruar një fluks i vogël, por në rritje i eksportit të vajrave esenciale, si edhe një rritje e kapacitetit përpunues në vend.

Baza e prodhimit përbëhet kryesisht nga BMA-të e egra që gjenden në të gjithë vendin.

Biodiversiteti i pasur në Shqipëri përfaqëson një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të BMA-ve. Më shumë se, 400 specie janë identifikuar si BMA të florës shqiptare, nga të cilat më shumë se 200 specie mbledhen dhe tregtohen.

BMA-të janë një sektor i rëndësishëm i ekonomisë rurale. Sondazhet tregojnë se, në disa zona rurale pothuajse të gjitha familjet marrin një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të tyre nga grumbullimi i BMA-ve.



po ndërmerren edhe nisma të tjera mbështetëse për këtë sektor që bart potenciale të larta ekonomike dhe punësimi.

Në programin me donatorët, kryesore në këtë drejtim është organizimi i një sërë trajnimesh në mbështetje të rritjes së cilësisë, me vëmendje të veçantë tek shmangia e materialeve dhe lëndëve toksike (PA/TA) si dhe arritja e mblendjes së qëndrueshme, me qëllim ruajtjen e biodiversitetit.

Trajnimet e zhvilluara në Dibër kanë përfshirë 505 kultivi-

Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (AREB).

Zonat rurale të vendit konsiderohen me potenciale të larta të bimëve mjekësore dhe angazhimi i grave në këtë sektor është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë.

Shqipëria ka një traditë të hershme në prodhimin dhe eksportin e bimëve mjekësore dhe aromatike. Më shumë se 95% e totalit të bimëve të mblendura, eksportohen. Ndërkohë 3/4 e sherebelës së importuar nga

Krifca me ambasadorën greke: Forcimi i bashkëpunimit në fushën e bujqësisë

Shqipëria dhe Greqia synojnë forcimin e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, priti në ambientet e Ministrisë, në një takim kortezie ambasadorën e re të Greqisë në Shqipëri, Konstantina Kamitsi.

Ministria Krifca publikoi në rrjete sociale momente nga takimi teksa informoi se “diskutuam mbi intensifikimin e bashkëpunimit mes dy vendeve tona në sektorë të ndryshëm që përfshijn bujqësinë”.

“U dakordësuam për nevojën e rritjes së bashkëpunimit dypalësh në fushën e prodhimit bimor dhe inputet e prodhimit bimor, zootekninë,



blegatorinë, peshkimin, çështjet veterinarë dhe fitosanitare”, u shpreh Krifca.

Gjithashtu theksoi ministria, “diskutuam për fusha të

reja bashkëpunimi në sektorin e sigurisë ushqimore dhe kërkimit shkencor në bujqësi, për të zhvilluar më tej marrëdhëniet dhe fqinjësinë e mirë”.

Programi IPARD III, masë të veçantë për mbështetjen e pyjeve

Zhvillimi i pyjeve do të përfshihet për herë të parë, në një paketë mbështetëse nën programin IPARD III, për të cilën Agjencia e Zhvillimit Bujqësor

Eranda Selmanaj, tha se, “në programin IPARD III është parashikuar një masë e veçantë mbi ngritjen dhe mbrojtjen e pyjeve ku parashikohet restau-

kombëtare, organizuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në kuadër të 100- vjetorit të Shërbimit Pyjor, Selmanaj vuri në dukje se, “AZHBR ndër vite ka mbështetur shërbimet mjedisore”.

Sipas saj, AZHBR në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe qeverinë Suedeze përmes projektit “Zhvillimi dhe Mbrojtja e Pyjeve (2018-2020)” ka kontribuar në ruajtjen dhe përmirësimin e ekosistemeve malore, zgjerimin e burimeve pyjore dhe parandalimin e zjarreve.

Punimet e konferencës u mbyllën me shpërndarjen e certifikatave të mirënjohjes atyre që ndër vite kanë kontribuar në këtë sektor dhe me një ekspozitë fotografike ku pasqyrohen bukuritë dhe pasuritë pyjore të vendit tonë.



dhe Rural (AZHBR) ka punuar dhe përgatitur masën përkatëse nën konsulencën edhe të ekspertëve të huaj.

Drejtoresha e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural,

rimi, përmirësimi i ekosistemeve pyjore duke trajtuar edhe sfidat klimatike”.

E pranishme në konferencën sensibilizuese për mbrojtjen dhe trajtimin e pyjeve si pasuri

Programi IPARD III, grante për investimet në agropërpunim

Agropërpunimi është rritur ndjeshëm gjatë 10 viteve të fundit duke arritur në rreth 25% të xhiros totale të bujqësisë. Tendencat janë shumë pozitive, të cilat tregojnë se sektori ka potencial të lartë për zhvillim dhe krijimin e vendeve të punës.


Volumi tregtar i shitjeve

për produkte të përpunuara dhe rritja e eksportit të produkteve me origjinë bimore, ndërkohë që ka startuar eksporti i produkteve me origjinë shtazore, pas përfundimit të procesit të reformave të rëndësishme të ndërmarrja në fushën e sigurisë ushqimore në të cilat është an-

investime të konsiderueshme për të modernizuar teknologjitë që përmirësojnë cilësinë dhe që përputhen me standardet e Bashkimit Europian.

Gjithashtu, edhe në zinxhir të mbyllur ftohës nga prodhuesit të konsumatorit, siç janë pikat e grumbullimit të qumështit dhe transportit me sistem ftohjeje.

Ndërkohë, për të rritur konkurrencën dhe performancën mjedisore të sektorit të përpunimit të mishit ka nevojë të inkurajohen investimet në përputhje me standardet e BE-së dhe përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve dhe përpunimit të nënprodukteve. Thertoret ende duhet të përmirësohen dhe të përmbushen standardet e sigurisë ushqimore dhe të mirëqenies së kafshëve.



dhe të ardhurave nga ky sektor është në vlerë dyshifrore, ndërkohë që punësimi është rritur me rreth 20%, mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme

gazhuar sektori. Ekspertët e MBZHR-së u shprehën se interesi i sipërmarrjeve në sektorin e përpunimit të qumështit mbetet i lartë për



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



**MBËSHTETJE FINANCIARE
PËR TË GJITHË FERMERËT**

**KREDI E DEDIKUAR
PËR MBJELLJEN E GRURIT**



BUJQËSIA ME KONTRATË

Bujqësia e kontraktuar "Contract Farming"

Në këtë stad të liberalizimit të tregut, globalizimit dhe zgjerimit të agrobiznesit



Përfitimet e bujqësisë së kontraktuar:

Bujqësia me kontratë është përdorur për prodhimin bujqësor për dekada, por popul-

ekziston rreziku që fermerët e vegjël të gjejnë vështirësi në pjesëmarrjen e plotë në ekonominë e tregut. Për këtë arsye bujqësia kontraktuale e organizuar mirë duket se ofron një mënyrë të rëndësishme të zgjidhjes së problemit përmes së cilës prodhuesit më të vegjël mund të performojnë në një mënyrë komerciale.

Bujqësia e kontraktuar nën termin "Contract Farming" përfshin prodhimin bujqësor që kultivohet në bazë të një marrëveshje ndërmjet blerësit dhe prodhuesve të fermave. Ndonjëherë ajo përfshin blerësin që specifikon cilësinë e kërkuar dhe çmimin, me fermerin që pranon ta prodhojë sipas kushteve të paracaktuara dhe të dorëzojë prodhimin në një periudhë të caktuar. Megjithatë, më shpesh, kontratat përshkruajnë kushtet për prodhimin e produkteve bujqësore dhe për dërgimin e tyre në ambientet e blerësit. Fermeri merr përsipër të furnizojë sasi të dakorduara të një produkti bujqësor ose blegtoral, bazuar në standartet e cilësisë dhe kërkesat e dorëzimit tek blerësi. Në këmbim, blerësi, zakonisht një kompani eksportuese ose përpunuese, pranon të blejë produktin, shpesh me një çmim që përcaktohet paraprakisht. Kompania shpesh pranon gjithashtu të mbështesë fermerin, p.sh. duke e furnizuar me inpute, duke ndihmuar në keshillimin agro-teknik dhe transportimin e produkteve në ambientet e saj.



lariteti i saj është rritur vitet e fundit. Përdorimi i kontratave është bërë tërheqës për shumë fermerë, sepse marrëveshja ofron një treg të sigurt dhe akses në mbështetjen e prodhimit. Bujqësia me kontratë është gjithashtu me interes për blerësit, të cilët kërkojnë furnizime të produkteve për shitje më tej përgjatë zinxhirit të vlerës ose për përpunim. Eksportuesit apo përpunuesit përbëjnë përdoruesit kryesorë të kontratave, pasi furnizimi i garantuar u mundëson atyre të shfrytëzojnë maksimalisht kapacitetin e tyre përpunues ose furnizuese të supermarketeve. Kontratat me fermerët gjithashtu mund të zvogëlojnë rrezikun nga sëmundjet ose moti dhe të lehtësojnë certifikimin, veçanërisht atë të standartit Global Gap, ISO 22000, gjë që po kërkohet gjithnjë e më shumë nga tregjet e Europiane. Ekzistojnë gjithashtu

përfitime të mundshme për ekonominë kombëtare, pasi bujqësia me kontratë çon në ekonomi të shkallës, të cilat, siç argumentojnë Collier dhe Dercon, "janë të detyruar të ofrojnë një sektor bujqësor më dinamik".

Megjithëse bujqësia me kontratë duhet të konsiderohet para së gjithash si një propozim tregtar, ajo është parë gjithashtu si një qasje efektive për të ndihmuar në zgjidhjen e shumë problemeve të aksesit në treg dhe furnizimit me inpute me të cilat përballen fermerët e vegjël. Lidhjet efektive midis kompanive dhe mijëra fermerëve shpesh kërkojnë përf-

shirjen e shoqatave ose kooperativave formale të fermerëve ose, të paktën, grupeve joformale të fermerëve. Mendohet se bujqësia kontraktuale është një formë e integritit vertikal brenda zinxhirëve të produkteve bujqësore në mënyrë që kompanitë eksportuese apo përpunuese të kenë një kontroll më të madh mbi procesin e prodhimit, sasisë, cilësisë, karakteristikave dhe kohën e prodhimit.

Tipet e kontratave në bujqësi:

Kontratat në bujqësi mund të kuptohen si kreditim i inputeve bujqësore si fara, plehra, kredi apo zgjerim tek një fermer në këmbim të të drejtave ekskluzive të blerjes mbi kultura të specifikuar. Ka disa mënyra për të klasifikuar skemat e fermave me kontratë.

Së pari, ekziston shkalla e

formalitetit në vetë kontratën. Në disa raste, kontrata është pak më shumë se një mar-

përcaktimit të çmimit dhe pagesave. Në disa raste, çmimi fiksohet në kohën e mbjelljes nga



Contract Farming

rëveshje e pashkruar midis një fermieri dhe një blerësi. Në anën tjetër ekstrem, kontrata është një dokument formal i shkruar që specifikon përdorimin e inputeve, metodat e prodhimit, standartet minimale të cilësisë dhe çmimit të blerjes. Kontratat formale ofrohen më shpesh nga firma të mëdha përpunuese ose eksportuese, veçanërisht kur blejnë nga fermerët e mesëm dhe të mëdhenj.

Së dyti, skemat e fermave me kontratë mund të klasifikohen sipas llojeve të angazhimeve të marra ndërmjet blerësit dhe shitësit, të cilën mund ta klasifikojmë në 3 kategori:

- Kontratë që specifikon tregun, përshkruan kushtet e transaksionit të shitjes në lidhje me çmimin, sasinë, kohën dhe atributet e produktit.

- Kontratë për sigurimin e burimeve, blerësi siguron edhe inpute bujqësore dhe asistencë teknike me kredi.

- Kontrate e prodhimit-menaxhimit, e cila specifikon mënyra në të cilën do të rritet prodhimi, si p.sh. dendësia e mbjelljes, përdorimi i pesticideve dhe koha e korjes.

Megjithatë, në praktikë, shumë kontrata kombinojnë elementë të të tre llojeve. Për shembull, kontrata mund të specifikojë metodat e prodhimit dhe kushtet e shitjes, si dhe ofrimin e inputeve për fermerët me kredi, pra ndërmjeteson edhe kreditimin e fermerëve. Një dimension i tretë në bujqësinë me kontratë është mënyra e

blerësi.

Në praktikë ndodh që nëse çmimi i tregut është më i lartë, mund të ndodhë që fermeri kryhen shitje në destinacion tjetër (fermeri shkel kushtet e kontratës duke shitur një pjesë ose të gjithë produktin në treg). Në të kundërt, nëse çmimi i tregut është më i ulët, blerësi mund të furnizohet nga tregu i lirë dhe jo nga fermerët e kontraktuar. Për të shmangur këto probleme, skema e fermave me kontratë duhet të mbështetet në çmimin me formulë, në të cilën blerësi pranon të paguajë një çmim bazuar në një çmim tregu, zakonisht çmimi i tregut plus një prim në përqindje.

Roli i rëndësishëm i blerësve dhe institucioneve të kreditimit në modelin e "Bujqësisë së Kontraktuar":

Organizimi i një skeme bujqësore me kontratë përf-



(Vijon nga faja 7)

paraqet një interes të lartë për 4 arsye kryesore:

- Kërkesa për lëndë të parë është e lartë nga fabrikat dhe njësitë e përpunimit të qumështit;

- Paraqitet një stabilitet në çmimin e blerjes së qumështit cilësor që luhet nga 70-80 lek/litër;

- Likujdime korrekte sipas grafikëve të vendosura në kontratë për blegtorët. Kjo specifikisht nga fabrikat e qumështit të konsoliduara;

- Mbështetje me grantet e IPARD-it për stalla, pajisje, sisteme mjelje, mekanikë bujqësore etj.

Fitimi në një fermë me 20 lope racë Holtshein, me

standarte dhe respektim të një racioni ushqimor të pasur (40-44 kg ushqim/krerë/ditë) është rreth 900,000 lek/vit. Në këtë fitim përfshihet shitja e qumështit, vicave dhe plehut organik.


Çfarë duhet të ketë parasysh një fermer për të investuar në një fermë blegtorale me 20 krerë lopë qumështi?

Për të pasur një fermë blegtorale efikase, fermerët duhet të ndjekin një sërë rregullash, për si më poshtë:

Pse duhet të investoni në ferma blegtorale për prodhim qumështi

- Investim në raca produktive dhe të përshtatshme me klimën e zonës psh. raca Holshtein, Simental, Xhersi etj.

- Materiali biologjik të jetë



cilësor;

- Kushtet e stallës të plotësojnë parametrat e mirëqënies së kafshëve të përcaktuara në ligj;

- Racioni ushqimor duhet të jetë i pasur në vlera ushqyese;

- Të respektohet legjislacioni në fuqi për investimin në mënyrë që të aplikohet në grantet IPARD psh. leje ndërtimi stalle, matrikullimi, Nipt fermerit etj;

Investimi në shtimin e numrit të krerëve në blegtorë, si dhe pajisjet apo stallet blegtorale, mbështeten me financim deri në vlerën 20 milion lekë nga institucioni mikro-financiar NOA. Proçedura e kreditimit është e menjëhershme dhe pa burokraci në operim.

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

TË USHQYERIT PLOTËSUES TË GICAVE NË MËMËZIM

Menjëherë pas lindjes, ushqimi i parë që marrin gicat në ditët e para është kulloshtra. Me kalimin e ditëve sasia e qumështit që gicat marrin nga dosa është i pamjaftueshëm, prandaj është i nevojshëm dhënia e ushqimit plotësues. Sasia e dhënies së ushqimit plotësues varet nga kërkesat e gicave dhe shkalla e plotësimit të tyre përmes qumështit të dosës (kërkesa e gicave për qumësht, sasia e siguruar përmes qumështit të dosës). Diferenca midis kërkesës së gicave në energji e proteina dhe sigurimit të këtyre nutrientëve përmes qumështit, fillon të rritet gjithnjë e më tepër pas javës së dytë. Prandaj menjëherë në këtë fazë duhet të fillohet me dhënien e ushqimit plotësues ose siç njihet ndryshe "Prestarter". Ushqimi plotësues duhet të fillojë në 7-10 ditët e para. Kjo bën të mundur që gicat të mësohen shpejt me ushqimin dhe të mos pësojnë asnjë goditje kur të marrin sasi më të madhe prej tij ose kur të këputen nga qumështi. Sistemi i të ushqyerit plotësues të gicave bazohet në përzjerje koncentratit që njihen me emrin "Prestarter" dhe "Starter".

Ushqimi "Prestarter" përmban 15 MJ ET/kg; 20-22% proteinë bruto; 1.25% lizinë dhe përdoret deri në fund të javës së 4-5-të. Ushqimi "Strater" përmban 13 MJ ET/kg; 18-21% proteinë bruto, 1.10% lizinë. Ushqimi "Strater" mund të jetë starter-I dhe starter-II, ku starter-I ka vlerë më të lartë ushqimore dhe përdoret

në gicat e këputur shumë herët, kurse starter-II ka vlerë më të pakët ushqimore dhe përdoret për gicat e këputur në moshën 35 ditëshe. "Starteri" mund të përdoret si ushqim plotësues deri sa gicat të arrijnë peshën 20-25 kg.

Për të rritur konsumin e ushqimit aplikohet futja në përzjerje e sheqerit ushqimor në masën 140-160 mg/kg përzjerje ose 5% të përzjerjes. Për plotësimin e kërkesave mineralo-vitaminike shtohen në racione premikse në masën 1.8-2%.

Tabela 1. Skemë orientuese e të ushqyerit për gicat në mëmëzim dhe pas këputjes

Mosha e gicit (në javë)	Sasia e ushqimit (g)/krerë/ditë	Tipi i ushqimit
2	100	Prestarter
3	150	Prestarter
4	200	Prestarter
5	300	Prestarter
6	400	Prestarter+ Starter
7	500	Starter
8	600	Starter
9	700	Starter
10	800	Starter

*Prestarter + Starter, fillon të përdoret në fillim të javës së gjashtë

Periodha	Sasia Prestarter (g)	Sasia Starter (g)
Dita e 1 ^{te} javës së 6 ^{te}	350	50
Dita e 2 ^{te}	300	100
Dita e 3 ^{te}	250	150
Dita e 4 ^{te}	200	200
Dita e 5 ^{te}	150	250
Dita e 6 ^{te}	100	300
Dita e 7 ^{te}	50	350
Dita e 1 ^{te} e javës së 8 ^{te}	0	400

Korrelacioni midis sasisë së ushqimit plotësues dhe moshë së gicave në mëmëzim mund të shprehet: $Y = 0.0044X2.80$

ku, Y: sasia ditore (g) e ushqimit që konsumon gici dhe X: mosha e gicit (në ditë).

Ushqimi plotësues përdoret për disa qëllime:

- Gicat në këputje do të kenë peshë më të madhe.
- Sistemi tretës pëson ndryshime, çka i përgatit gicat të mësohen më shpejt me ushqimin bimor pas këputjes.
- Dosat dhe veçanërisht paradosat, do të humbasin më pak peshë, pse gicat eventualisht do të

pinë më pak qumësht, kur të nisin të marrin ushqimin plotësues.

Disa konsiderata që duhen mbajtur parasysh në dhënien e ushqimit plotësues:

- Dhënia e ushqimit plotësues fillon zakonisht në moshën 10-14-ditëshe të jetës së gicave.
- Në ditët e para, u jepet disa herë në ditë sasira të vogla 10-30 g/ditë, ku mund të arrijë dhe deri në 60-100 g/ditë.
- Forma më e mirë e përdorimit është ajo e peletuar.
- Ushqimi jepet i thatë, në vend të pastër, larg dosës dhe ndërrohet çdo ditë që të evitohet prishja dhe fermentimi i tij.
- Kur gicat e konsumojnë mirë ushqimin, duhet të nisë përdorimi i automateve të ushqimit, por me kusht që të mos mbushen plot.
- Temperatura optimale e mjedisit ku mbahen gicat në javën e parë duhet të jetë 32 oC dhe ulet gradualisht në 20 oC në javën e katërt.
- Gicat ndahen nga dosa në bokse me ndarje të veçantë. Për gicat në këtë ndarje përdoret një burim ngrohjeje me rreze infra të kuqe.
- Të sigurohet ujë i pastër dhe në sasi të bollshme. Për çdo 1 kg ushqim deri në moshën 4-javëshe nevojiten 6-8 l ujë, që përbën 10% të peshës së gjallë të gicave, ose sasia e lëndës së thatë të marrë me ushqim x 6.

Përgatiti: Fidel Gjurgji

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale, QTTB-Fushë Krujë;
E-mail:qttbfushekrufe@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

“ROLI I PLEHRAVE ORGANIKE, NORMA DHE KOHA E PLEHËRIMIT ORGANIK NË DRURËT FRUTORË”

Normat e plehërimit organik në pemët dru-frutore

Tabela 1: Normat e plehërimit organik për pemët frutore farore në prodhim

Rend.i.planif. kg/rrënjë (farore)	Pleh organik kg/rrënjë sipas nivelit të pjellorisë së tokës		
	T. Varfra	T. Mesme	T. Pasura
Deri 20	60	50	40
40	70	60	50
60	95	80	60
80	100	80	70
100	130	100	80
Mbi 100	170	140	100

Tabela 2: Normat e plehërimit organik për pemët frutore bërthamore në prodhim

Rend.i.planif. kg/rrënjë (bërthamore)	Pleh organik kg/rrënjë sipas nivelit të pjellorisë së tokës		
	T. Varfra	T. Mesme	T. Pasura
Deri 10	40	30	25
20	50	40	30
30	65	55	35
40	70	55	35
50	75	60	40
Mbi 50	100	80	50

Tabela 3: Normat e plehërimit organik për agrumet në prodhim

Rend.i.planif. kg/rrënjë (agrumet)	Pleh organik kg/rrënjë sipas nivelit të pjellorisë së tokës		
	T. Varfra	T. Mesme	T. Pasura
Nga 15-30	30	20	15
45-60	45	35	20
75	45	30	25
90-100	50	40	35
Mbi 100	70	50	40

Tabela 4: Normat e plehërimit organik për Ullirin në prodhim

Rend.i.planif. kg/rrënjë (ulliri)	Pleh organik kg/rrënjë sipas nivelit të pjellorisë së tokës		
	T. Varfra	T. Mesme	T. Pasura
Deri 10	30	35	10
20	30	25	20
30	35	30	20
40	40	30	25
50	40	30	25
60	45	40	30
80	50	40	30
100	60	45	40
Mbi 100	70	50	40

Koha e plehërimit me plehra organike
Koha më e përshtatshme e plehërimit organik është muaji Nëntor ose Janar – Shkurt. Kjo përkon me periudhën kur drufrutorët hyjnë në qetësinë dimërore dhe kërke-

sat për elementë ushqyes janë të pakta. Arsyeja e hedhjes së këtyre plehrave në këtë periudhë është se plehrat organike gjatë përmbysjes në tokë dekompozohen plotësisht dhe elementët ushqyes mineralizohen duke u bërë të gatshëm për tu asimiluar lehtësisht nga sistemi rrënjor i drufrutorëve.

Si dhe sa herë bëhet plehërimi?
Plehu hidhet jo më afër se 0.7-1m nga trungu ose ndërmjet rreshtave për të mos dëmtuar sistemin rrënjor. Pemët e reja zakonisht plehërohen në mënyrë të lokalizuar, vetëm në atë sipërfaqe toke ku ndodhet sistemi rrënjor. Gradualisht, me rritjen e pemëve rritet dhe sipërfaqja e plehëruar. Plehërimi organik rekomandohet të plehërohet së paku 1 herë në 2-3 vjet. Plehu organik përmbysset menjëherë në thellësinë 25-30 cm gjatë punimit Asimilimi i elementëve ushqyes që përmban plehu organik zakonisht zgjat 3 - 4 vjet.



Pamje nga një ullishte me plehim organik para përmbysjes në tokë.

Përgatiti: Fetah Kazia; Florjana Çela

Drejtoria e Shërbimit të Tokës dhe Ujërave;
QTTB-Fushë Krujë; E-mail:qttbfushekrufe@yahoo.com

Përdorimi i plehrave organike në drurët frutorë ka një rëndësi të veçantë në ruajtjen dhe rritjen e pjellorisë së tokës bujqësore, në cilësitë e tokës si (pH, aciditeti hidrolitik, shumën e bazave të thithura, lagështirën produktive etj.) në numrin e përgjithshëm të mikroorganizmave dhe në aktivizimin e proceseve mikrobike në tokë.

Sistemi rrënjor i dru-frutorëve ka aftësi të zhvillohet në thellësi dhe në gjerësi, të marrë ujin dhe lëndët ushqyese nga thellësitë e tokës por plehërimi plotësues mbetet një nga masat më të rëndësishme agroteknike. Kjo spjegohet me masën e madhe organike që largohet nga pema në sajë të vjeljes së frutave dhe prerjes se degëve gjatë krasitjeve dimërore dhe ato vegjetative.

Zakonisht plehërimi me plehra organike bëhet para mbjelljes, gjatë mbjelljes dhe në fazën e rritjes dhe të prodhimit të dru frutorëve. Nevojat e pemëve frutore për elementë ushqyes në fazën e prodhimit varet nga lloji, mosha por dhe nga rendimenti i planifikuar, treguesit cilësorë që kërkohet të arrihen, nga pjelloria e tokës, plehërimet e përdorura më parë si edhe tërësia e teknologjisë që zbatohet në praktikë. Në mbështetje të këtyre faktorëve ofrojmë normat e plehërimit si më poshtë.

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUEJË

Ketoza ose acetonemia është një sëmundje metabolike. Hypoglicemia është faktori kryesor që përfshihet në shpërthimin ose zhvillimin e shenjave klinike të ketozës. Lopa ka një rënie të moderuar në prodhimin e qumështit dy deri katër ditë para shpërthimit të shenjave klinike. Kjo sëmundje është më e zakonshme në lopët me prodhimtari të lartë qumështi në fillim të laktacionit. Së dyti ketoza është rezultat i sëmundjeve të tjera që mund të shfaqen në atë stad të laktacionit. Lopët e mishit gjithashtu mund të vuajnë prej ketozës gjatë barsmërisë.

Ketoza në Lopët e Qumështit

Shenjat klinike përfshijnë refuzimin ndaj drithërave dhe ushqimeve të koncentruara dhe një rënie të papritur të prodhimin të qumështit. Ka një erë acetoni gjatë frymëmarrjes dhe urinitit. Disa lopë mund të shfaqin shenja nervore të cilat përfshijnë salivacion, përtpyje jo normale, lëpirje të mureve, dyerve ose pjesëve metalike, kordinim të keq me shenja verbërie dhe agresioni. Shenjat nervore shpesh zgjasin për disa orë. Lopët e prekura kanë infiltrim yndyror dhe degjenerime në mëlçi. Për të plotësuar kërkesat e prodhimin të qumështit lopët mund të aktivizojnë dy burime ushqimore, ushqime të marra dhe rezervat trupore. Gjatë laktacionit të hershëm energjia e marrë është e pamjaftueshme të mbulojë energjinë e larguar me prodhim qumështi, për pasojë kafshët kanë një balancë energjitike negative.

Në fermat tradicionale kjo konsiderohet si një situatë metabolike normale në lopë me prodhimtari të lartë qumështi. Këto lopë do të kenë një rritje të lehtë në gjak të niveleve të ketoneve dhe mund t'i eskretojnë këto me urinë dhe qumësht.

KETOZA NË GJEDHË

Lopët në laktacion të hershëm ndodhen në një gjendje pak delikate dhe në një stres që shkakton reduktim në marrjen e ushqimit, që çon në shpërthimin e shenjave të ketozës. Një reduktim në prodhimin e acidit propionik paraardhësi kryesor i glukozës në ruminantë do të rezultojë në hypoglicemi. Hypoglicemia çon në mobilizimin e acideve yndyrore të lirë dhe glicerolit. Meqë mëlçia nuk arrin t'i përpunojë ndodh oksidimi i tyre për shkak të mungesës së energjisë të nevojshme. Acetil CoA konvertohet në ketone dhe deri në acetone. Indet ashtu si mëlçia mund t'i përdorin këto ketone por në qoftë se prodhimi i tyre zgjat, atëhere fillon akumulimi i tyre në muskuj dhe inde e për pasojë ndodh ketoza. Këto pastaj eskretohen në qumësht dhe urinë.

Reduktimi i prodhimin të acidit propionik është si rezultat i të ushqyerit keq ose reduktimit të ushqimit të marrë prej mungesës së apetitit. Mungesa e apetitit shkaktohet prej prishjes së kualitetit të foragjereve, papritmas ndryshojnë dietën ose dhjamosen së tepërmi në pjellje. Të tjerë faktorë rreziku janë pariteti, ketoza në laktacionin e mëparshëm, 305 ditë prodhim qumështi në laktacionin e mëparshëm dhe përqindja e proteinës së qumështit në këto laktacione.

Ketoza Dytësore

Ketoza dytësore ndodh zakonisht si rezultat i sëmundjeve që shkaktojnë uljen e apetitit në laktacionin e hershëm të tilla si zhvendosja e abomasumit, mastitet, metritet, etj. Mungesa e

kobalit gjithashtu shkakton ketozë. Kobalti është i nevojshëm për sintezën e mikroflorës bakteriale të rumenit, të vitaminës B12 dhe është esenciale për përdorimin adekuat të acidit propionik.



Foto lopë me Ketozë

Ketoza në Lopët e Mishit

Ndërsa ketoza në laktacionin e hershëm vepron kryesisht në lopët me veprimtari të lartë, ketoza ose toksemia e barrës në barsmërinë e vonë vepron kryesisht në lopët e mishit. Lopët e të gjitha moshave mund të preken, por kafshët e dhjamosura dhe ato që kanë binjakë janë më të rrezikuara. Lopët e mishit shpesh dhjamosen në kullotat e mira verore. Në qoftë se të njëjtat lopë nuk do kenë akses për ushqime të kualitetit të lartë në muajt e dimrit, kur ato të jenë në barrën e vonë do t'i nënshtrohen ketozës për arsye të energjisë së ulët të marrë. Kafshët e prekura zakonisht janë shtatë deri nëntë muaj barse. Shenjat e para klinike i kanë njësoj si lopët në ketozë në laktacionin e hershëm. Mundet që shumë lopë të mbeten shtrirë shpejt

dhe më të shumtat ngordhin nga tre deri në katërmëdhjet ditë më vonë. Lopët që preken rreth pjelljes shpesh ngordhin gjatë saj.

Trajtimi

Trajtimi synon të normalizojë gliceminë dhe të zvogëlojë koncentracionet trupore të ketoneve. Administrimi i bolusve 500 ml/50% të solucionit të dekstrosës është terapi e zakonshme. Ky solucion është hiperosmotik dhe administrohet perivaskular. Si rezultat disa inde ejnten dhe irritohen prandaj duhet bërë kujdes gjatë aplikimit. Terapia me boluse glukozë në përgjithësi rezulton me shërim të shpejtë, veçanërisht në rastet kur ndodh afër pikut të laktacionit. Megjithatë shpesh efekti është i përkohshëm dhe ndodhin recidiva.

Administrimi i glukokortikoidëve përfshin dexamethason ose isoflupredone acetat 5-20 mg/dozë i/m, në përgjithësi rezulton një përgjigje më e qëndrueshme. Terapia me glukozë dhe glukokortikoid mund të përsëritet sa herë është e nevojshme. Propylen glukoli (250-400 mg/dozë) vepron si paraprirës i glukozës dhe mund të jetë si terapi e ketozës veçanërisht në rastet e lehta ose në kombinim me terapi të tjera. Kjo dozë mund të aplikohet dy herë në ditë. Mbidoza me propylen glukol çon në depresion të SNQ (Sistemi Nervor Qendror).

Rastet e ketozës që ndodhin brenda një deri dy javëve të para pas pjelljes shpesh janë refraktare ndaj terapisë po kështu edhe rastet afër pikut të laktacionit. Në këto raste insulina me afat të gjatë veprimi i/m 150-200 UI/ditë mund të jetë e dobishme. Insulina mund të jepet në kombinim me glukozën ose glukokortikoid për të parandaluar hipogliceminë.

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale: QTTB-Fushë Krujë:
E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com

DREJTORIA E SHËRBIMIT KËSHILLIMORË, SHKENCËS DHE INOVACIONIT

Për prodhuesit e perimeve në serra:

Në kushtet e temperaturave të ulëta, duke filuar nga -4 gradë Celsius në mjediset e jashtme, disa kultura perimore në serra rrezikohen seriozisht, prandaj rekomandohet të merren masa urgjente si vijon:

1. Të kontrollohen dhe eliminohen në maksimum mundësitë e futjes së ajrit të ftohtë në serrë;
2. Të kontrollohen plastmasat e brendshëm dhe tunelet në serra. Në qoftë se nuk janë të vendosur plastmasat e brendshëm anësorë dhe tunelet, është e domosdoshme të vendosen urgjentisht, mundësisht 2 plastmase me një distancë izotermike jo më të vogël se 20 cm njëra shtresë nga tjetra;
3. Të shfrytëzohen të gjitha mundësitë alternative për ngrohjen me energji elektrike, gaz, etj.
4. Të minimizohen ujtitet, sepse rritja e lagështisë në tokë ul përqëndrimin e kripërave në lëngun qelizor, duke rritur rrezikun e dëmtimit të bimëve nga temperaturat e ulta.
5. Në qoftëse, ujtitet janë të domosdoshme, të bëhen me norma minimale uji dhe të shoqërohen me plehërime të lëngshme, me përbajtje të lartë fosfori e potasi me qëllim që të rritet përqëndrimi i lëngut qelizor.

Për prodhuesit e pemëve frutore dhe vreshtave:

Pemët frutore dhe hardhia durojnë relativisht mirë temperaturat e ulëta, megjithatë me uljen e

Këshilla/ rekomandime për fermerët, për masat që duhen marrë për mbrojtjen e kulturave bujqësore dhe specieve të kafshëve nga temperaturat e ulëta

tyre nën -10 °C (gradë Celsius), rekomandohet:

1. Të ndërpriten procesi i krasitjes deri në normalizimin e temperaturave;
2. Për fidanat e agrumeve, që nuk janë ambjentet e mbrojtura, të merren masa për mbulimin e tyre ose për ngritjen e temperaturave të ndizen zjarre përreth vendeve ku janë vendosur/mbahen;
3. Gjatë periudhës/orëve me temperatura të ulëta nën 10 gradë celsius, të ndizen zjarre sidomos në parcelat me agrume.

Për prodhuesit e të lashtave (grurë, elb, tërshërë, thekër):

Fermeret që kultivojnë të lashta këshillohen të kryejnë menjëherë kullimet e ngastrave të mbjella. Lagështia e tepërt prish strukturën e tokës, ndikon në humbjen e numrit të bimëve dhe si rezultat ka rënie të rendimentit, cilësisë, shfaqje të sëmundjeve, kalbëzim dhe zverdhje të gjeteve.

Po kështu, gjatë ngricave dhe lagështirës, krijohet fryrje ose bymimi i tokës dhe shkaktohet krijim i kores, duke ngritur lart bimët dhe duke prishur sistemin rrënjor të tyre, gjë e cila shkakton humbje në bimë.

Për blegtorët që mbarështojnë gjedh dhe derra:

Pavarësisht se shumica e kafshëve të fermës përshtaten relativisht mirë me motin e ftohtë, era e fortë dhe i ftohti ekstrem mund të shkaktojnë probleme për gjedhin dhe derrat. Më poshtë, shihni rekomandimet për blegtorët:

1. Strehoni kafshët në ambiente të mbyllura;
2. Jepuni kafshëve ushqimi të bollshëm të barit të thatë, foragjereve dhe koncentreve, sepse i ndihmon kafshët të mbajnë temperaturën e trupit dhe t'i mbijetojnë temperaturave shumë të ulëta. Si pasojë e motit të ftohtë gjedhët dhe derrat kanë nevojë për një një rritje 100% të kërkesave për energji për t'i ndihmuar ato të mbajnë temperaturën dhe funksionin normal të trupit;
3. Sigurohuni që ushqimi të jetë me cilësi të mirë dhe me lëndët ushqyese të nevojshme për llojin e bagëtisë që kenë. Në rast se nuk plotësohen nevojat ushqimore, ulet prodhimin e qumështit dhe krijohet probleme me riprodhimin;
3. Konsumi i ujit të kafshëve rritet për shkak të ritmeve të larta metabolike të nevojshme për të ruajtur ngrohtësi. Sigurohuni që uji të jetë i pastër, pa akull

dhe me sasi të mjaftueshme;

4. Rritja e kohës së qëndrimit në ambiente të mbyllura do të rrisë sasinë e jashtëqitjeve. Mbani shtratin sa më të thatë dhe të pastër në mënyrë që të shmangni shtimin e amoniakut në ajër, pasi kjo do të irritonte frymëmarrjen e bagëtive dhe do të rriste ndjeshmërinë ndaj baktereve dhe viruseve;

5. Duhet të kufizohet koha e ndenjes së bagëtive në zona me baltë, për të shmangur problemet me thundrat dhe dëmtimet e shakatuara gjatë lëvizjes;

6. Gjymtyrët e bagëtive në temperatura shumë të ulëta duhet të jenë të thata. Ato mund të humbasin veshët dhe bishtat e tyre. Ndërsa meshkujt do të pësonin dëmtime në organet riprodhuese, të cilat mund të dëmtojnë pjellorinë ose aftësinë e kafshës për t'u riprodhuar;

7. Gjatë të ftohtit, kafshët duhet të monitorohen më shpesh. Kafshët që dridhen duhet të futen brenda, nëse është e mundur, për t'u ngrohur. Një ndryshim i papritur i temperaturës mund të çojë në probleme të frymëmarrjes;

8. Batanijet mund të përdoren për kafshë individuale por me kushtin që të jenë të thata;

9. Kafshët e reja (viçat e porsa lindur, gicat etj.) janë më të rrezikuara nga temperaturat e ulëta. Ato mund të kenë nevojë për ngrohje. Për ngrohje mund të përdorni pajisje elektrike, gazi dhe me dru.

Drejtoria e Shërbimit Këshillimorë, Shkencës dhe Inovacionit
www.bujqesia.gov.al

(Vijon në numrin e ardhshëm)

KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji shkurt 2023

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Pamja e qiellit gjatë muajit shkurt 2023

Më 5 shkurt - Hëna e plotë. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës nga

një dite me borë dhe shi të përzier do të mbetet në thelb konstante 1% gjatë gjithë kohës dhe mundësia e një dite me vetëm dëborë do të mbetet në thelb konstante 0% gjatë gjithë

Parashikimi i motit për muajin shkurt 2023 në Tiranë (Zona bregdetare)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C, Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli. Rows 1-28.

Parashikimi i motit për shkurt 2023 në Korçë (Zona e ftohtë)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C, Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli. Rows 1-28.

Dielli dhe faqja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar. Kjo fazë do të ndodhë në orën 19:28 UTC. Kjo hënë e plotë njihet nga fiset e hershme vendase amerikane si Hëna e borës, sepse bora më e madhe zakonisht binte gjatë kësaj periudhe të vitit. Duke qenë se gjuetia është e vështirë, kjo hënë është njohur nga disa fise edhe si Hëna e Urisë.

Treguesit mesatarë klimatike gjatë muajit shkurt 2023

Table with columns: Treguesit, Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Dibër, Gjirokastrë. Rows: Temperatura e ajrit, Mesatare (°C), Maksimale (°C), Minimale (°C), Më e larta gjatë viteve (°C), Më e ulta gjatë viteve (°C), Numuri i ditëve me Tempnën- 0°C (Ditë dhe %), Numuri i ditëve me Temp nën + 18°C, Era, Shpejtësia e erës (Km/Orë), Temperatura e erës (°C), Reshjet (Shiu), Shi (mm), Numuri i ditëve me shi (Ditë dhe %), Sasia rekord e shiut gjatë një dite (mm dhe viti), Dëborë (cm), Lagështia e ajrit (%), Shikueshmëria (Km), Mbulimi i qiellit me re (%), UV index, Orë me diell nëDitë, Gjatësia e ditës (Ore), Vlerësimi i muajit.

Më 20 shkurt - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës. Kjo fazë do të ndodhë në orën 08:05 UTC. Kjo është koha më e mirë e muajit për të vëzhguar objektet të zbehta si galaktikat dhe grupimet e yjeve, sepse nuk ka dritë të hënës që të ndërhyjë.

dita më e nxehtë e vitit, temperaturat në Tiranë zakonisht variojnë nga 18° C në 32° C, ndërsa më 4 janar, dita më e ftohtë e vitit, ato shkojnë nga 0° C në 11° C .

55%, ndërsa më 21 korrik, dita më e qartë e vitit, mundësia e qiellit të qartë, është 91%.

Zhvillimi i reve

Muaji shkurt në Tiranë, do të përfjetojë në thelb një mbulesë të vazhdueshme me re, me përqindjen e kohës që qielli është me vranësira ose kryesisht me re, do të mbetet rreth 52% gjatë gjithë muajit. Mundësia më e lartë e kushteve me vranësira ose kryesisht vranësira është 53% më 23 shkurt.

Drita e Diellit

Gjatë muajit shkurt në Tiranë, zgjatja e ditës do të rritet me shpejtësi. Nga fillimi deri në fund të muajit, kohëzgjatja e ditës do të rritet me 1 orë e 8 minuta, duke nënkuptuar një rritje mesatare ditore prej 2 minuta e 32 sekonda dhe rritje javore prej 17 minuta e 42 sekonda.

Dita më e kthjellët e muajit do të jetë 14 shkurti, me kushte të kthjellëta, kryesisht të kthjellëta ose pjesërisht me vranësira në 50% të rasteve. Për referencë, më 7 dhjetor, dita më e vrenjtur e vitit, shansi i kushteve të mbuluara me re ose më së shumti me re është

Dita më e shkurtër e muajit do të jetë 1 shkurti me 10 orë e 4 minuta ditë dhe dita më e gjatë do të jetë 28 shkurti me 11 orë e 12 minuta ditë.

Agimi më i vonshëm i muajit në Tiranë do të jetë në ora 6:52 e mëngjesit të datës 1 shkurt dhe lindja më e hershme e diellit do të jetë 35 minuta më herët në orën 6:17 të mëngjesit të datës 28 shkurt.

Perëndimi më i hershëm i

Kalendari, fazat e hënës dhe shënjat astrologjike për muajin shkurt 2023

Table with columns: Dt., Dita, Dita e Vitit, Dielli (Lind, Perëndon), Zgjatja e ditës, Hëna (Lind, Perëndon), Fazat e Hënës (Faza, %, Dita), Shënjat Astrologjike. Rows 1-28.

diellit do të jetë në orën 16:56 më 1 shkurt dhe perëndimi i fundit i diellit do të jetë 33 minuta më vonë në 17:29 më 28 shkurt.

Për referencë, më 21 qershor, dita më e gjatë e vitit, Dielli lind në orën 5:07 të mëngjesit dhe perëndon 15 orë, 10 minuta më vonë, në orën 20:17, ndërsa më 21 dhjetor, dita më e shkurtër e vitit, dielli lind në orën 7:03 të mëngjesit

dhe perëndon 9 orë e 11 minuta më vonë, në orën 16:14.

Reshjet

Në Tiranë, mundësia për një ditë të lagësht gjatë muajit shkurt do të jetë në thelb konstante, duke mbetur rreth 31% gjatë gjithë kohës. Gjatë muajit shkurt në Tiranë, mundësia e një dite vetëm me shi do të mbetet në thelb konstante 29% gjatë gjithë kohës, mundësia e

kohës.

Në Tiranë mund të presësh reshje shiu afërsisht në gjysmën e muajit shkurt. Priten afërsisht 8 deri në 15 ditë shi. Gjithashtu gjatë muajit shkurt në Tiranë mund të priten disa ditë me dëborë.

Për referencë, mundësia më e lartë ditore e vitit për një ditë të lagësht është 36% më 5 dhjetor

Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

